



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PRRENJAS

Nr. 2987 prot.

Prrenjas, më 27 . 11 . 2024

**SHPLLJE PËR 1 (NJË) VEND TË LIRË PUNE**

**INSPEKTOR NË INSPEKTORIATIN VENDOR TË MBROJTJES SË TERRITORIT**

Në zbatim të nenit 4, të ligjit Ligj Nr.9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" i ndryshuar, Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Bashkia Prrenjas shpall procedurat për punësim për pozicionin:

- 1 (një) inspektor në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit
- Afati për dorëzimin e dokumentave: 06.12.2024

**Inspektor IVMT:**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të IVMT janë:

1. Ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë.
2. Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara, inspektori merr masat e mëposhtme:
  - a. vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
  - b. vendos gjyba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
  - c. paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;
  - d. vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
  - e. vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
  - f. përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi
  - g. jep informacionin e kërkuar IVMT-së, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

### **1.1 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA**

Inspektorët e IVMT duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë ose mjedisit.

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për aplikim
- b- b- Curriculum Vitae
- c- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- d- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- e- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- f- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- g- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- h- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- j- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- k- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore.
- l- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në Zyrën e sportelit në Bashki brenda dates 06.12.2024

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT**

Në datën 10.12.2024, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Prrnjas do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Prrnjas, në stendat e informimit të publikut pranë Bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së punësimit do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrnjas, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- \*Njohuritë mbi Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin E Ndërtimit” (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- \*Njohuritë mbi Ligj Nr. 107/2014 “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit”
- \*Njohuritë mbi VKM 408, DATË 13.5.2015“Për Miratimin E Rregullores Së Zhvillimit \*Të Territorit”, të Ndryshuar
- \*Njohuritë mbi VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”,
- \*Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- \*Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- \*Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- \*Njohurite mbi Ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

## **1.5 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, intervistës me gojë , Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Prrrenjas do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Prrrenjas.

